



PERKTHIM NGA GJUHA BULLGARE

Akti i themelimit i "First Investment Bank-Albania" SHA

- 1.1 "First Investment Bank-Albania" SHA do ushtroje veprimtarine e saj ne perputhje me ligjin No 8365/02.07.1998 per bankat ne Republiken e Shqiperise dhe te akteve te tjera normative te zbatueshme ne veprimtarine tregtare (këtu më poshtë i quajtur "Legjislacioni bankar"), Ligji nr. 7638 datë 19.11.1992 " Për shoqëritë tregtare" (këtu më poshtë i quajtur " Legjislacioni tregtar"), me të gjitha dispozitat e tjera ligjore dhe rregulloret e zbatueshme, si dhe me këtë statut.

Neni 1 **Themelimi**

Shoqeria anonime "First Investment Bank-Albania" (këtu më poshtë i quajtur "Banka"), do te themelohet ne baze te ligjeve te Republikes se Shqiperise.

Neni 2 **Themeluesit**

Me kete akt personat e meposhtem themelojne Banken:

1. "First Investment Bank" AD, shoqeri private e themeluar dhe ekzestuese ne perputhje me ligjet e Bullgarise, mbajtese e Licenzes No 17, e leshuar nga Banka kombetare tregtare ne 14.09.1995, dhe e regjistruar ne regjistrin tregtare buulgar me numer 18045/1993, me adrese rruga "Stefan Karaxha" No 10, Bashkia "Sredec", Sofia, Bullgari, e perfaqesuar nga Stanimir Ivanov Mutafchiev, i autorizuar nga Bordi drejtues me autorizim .
2. "First Financial Brokerage House" Ltd., shoqeri private e themeluar dhe ekzestuese ne perputhje me ligjet e Bullgarise e regjistruar ne regjistrin tregtare buulgar me numer 1011/1991, me adrese rruga "Luben Karavellov" No 4, Bashkia "Sredec", Sofia, Bullgari, e perfaqesuar nga Todor Ludmilov Breshkov, dhe
3. "First Insurance Brokerage Company" AD, shoqeri private e themeluar dhe ekzestuese ne perputhje me ligjet e Bullgarise, e regjistruar ne regjistrin tregtare



bulgar me numer 9847/2003, me adrese rruga "Luben Karavelov" No 4, Bashkia "Sredec", Sofia, Bullgari, e perfaqesuar nga Borislav Kirilov Niklev.

Neni 3

Adresa e drejtimit

Selia e Bankës është në adresën: Bulevardi "Zogu i I-rë", Nr.64, Tiranë, Shqipëri. Banka mund të themelojë zyra përfaqësie, degë dhe/ose filiale brënda dhe/ose jashtë Republikës së Shqipërisë, ne perputhje me vendimin e aksionereve dhe ligjet e Republikës së Shqipërisë.

Neni 4

Objekti

Qëllimi kryesor i Bankës është të kryejë shërbime bankare kryesisht ndaj ndërmarrjeve private të vogla, të mesme dhe të mëdha në Shqipëri dhe të sigurojë të ardhura të arsyeshme në kapital për aksionerët e saj.

Të angazhohet në aktivitetin tregtar të parave në depozita, të pranuar publikisht dhe të përdorë këto fonde me qëllim dhënie e huasë individëve dhe/ose entiteteve dhe investime për llogari të saj dhe duke marrë përsipër të gjitha risqet.

Neni 5

Aktivitetet

Me qëllim arritjen e synimeve të saj, Bankës i lejohet të ushtrojë çdo lloj aktiviteti bankar dhe financiar në Republikën e Shqipërisë dhe jashtë saj, të cilat mund të realizohen nga banka tregtare në perputhje me Legjislacionin bankar dhe akte të tjera, si vijon:

1. të grumbullojë depozita;
2. të japë kredi;
3. të ofrojë shërbimin e pagesave dhe arketimeve;
4. të emetojë dhe administrojë mjetet e pagesave;
5. të ofrojë garanci bankare dhe garanci të tjera;
6. të ndërmjetësojë për transaksionet monetare (duke përfshirë valutat);
7. ofrimi i shërbimeve të lidhura me depozitat e kursimit;
8. të marrë hua mjete financiare dhe të blejë ose të shesë për llogari të saj apo për llogari të klienteve instrumenta të tregut të parave, letrat me vlerë të borxhit, kontrata të së ardhmes (futures) dhe kontrata me kusht (option) që lidhen me letrat me vlerë të borxhit ose me normat e interesit;
9. leasing financiar
10. të shërbejë si agjente ose keshilltare financiare (ketu nuk përfshihen shërbimet e parashikuara në pikën 1 dhe 2)



11. kembim valute perfshire ketu edhe kontratat e se ardhmes (futures) per kembime valutorc)
12. sherbime besimi (trust), perfshire pa kufizim investimin dhe administrimin e fondeve te besuara (fiduciare);
13. sherbime si administruese e portofolit te investimit ose te keshilltarit per investimet;
14. sherbimi per nenshkrimin dhe shperndarjen e letrave me vlere te borxhit dhe te pronesise, si edhe te tregetimin e letrave me vlere te pronesise per llogari te saj ose te klienteve.

5.2 Banka lejohet të kryejë të gjitha aktivitetet e mësipërme bankare e financiare:

- a. me kusht që ato të qëndrojnë brenda qëllimit të objektivave;
- b. me kusht që Banka të jetë licensuar për të kryer këto aktivitete dhe që Banka të ketë kapitalin e autorizuar nga Legjislacioni Bankar për të kryer aktivitetet e lartpërmëndura (veçanërisht për aktivitetet e përcaktuara në pikat 11 dhe 14); dhe
- c. në lidhje me aktivitetet e përcaktuara në pikat 8 dhe 9 deri në 14, me kusht që Këshilli Drejtues i Bankës të ketë miratuar kryerjen e këtyre shërbimeve.

Neni 6 **Afati**


Banka është themeluar me qëllimin të veprjë për një periudhë kohe të pacaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit në Regjistrin Tregtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Neni 7 **Kapitali themeltar**

7.1 Kapitali themeltar i Bankës është 1,000,000,000 (një miliard) Lekë, i ndarë në 1 000 000 (nje milion) aksione me një vlerë nominale 1,000 (nje mijë) Lekë sejcili.

7.2 Kapitali themeltar i Bankës përbëhet nga kontribute në para dhe është tërësisht i nënshkruar.

7.3 Aksionet janë aksione të regjistruara (nominative) dhe duhet të regjistrohen në Librin e Aksionerëve (që pasqyron emrat dhe adresat e aksionerëve, si dhe numrin dhe vlerën e aksioneve të zotëruara nga aksionerët përkatës), i cili mbahet pranë Shoqërisë. Ndryshimet që prekin aksionet, duhet të regjistrohen në Librin e Aksionerëve.



7.4 Kapitali nënshkruhet dhe do të shlyhet në shumat e mëposhtme nga aksionerët e mëposhtëm:

Aksioner	Shuma në Lekë	Në %
First Investment Bank AD Sofia	999,998,000	99,9998
“First Financial Brokerage House” Ltd	1,000	0,0001
“First Insurance Brokerage Company” AD	1,000	0,0001

7.5 Dokumenti i pagesës së kontributeve në para si dhe lista e aksionerëve do të depozitohet në Bankën e Shqipërisë.

Neni 8 Drejtimi dhe mbikqyrja


8.1 Banka drejtohet dhe kontrollohet nga një Këshill Drejtues anëtarët e të cilëve zgjidhen nga mbledhja e aksionerëve. Numri i anëtarve të Këshillit Drejtues është tek dhe jo më pak se 5 anetare.

8.2 Këshilli i parë drejtues do të ketë këto përberje, si vijon:

1. z. Matthew Aleksandrov Mateev, qytetar i Republikës së Bullgarisë, lindur në Sofie, në 02.07.1959, me pashaportë No 304068249;
2. znj. Maya Lubenova Georgieva, qytetare e Republikës së Bullgarisë, lindur në Sofie, në 02.09.1953, me pashaportë No 330917139;
3. z. Evgeni Lukanov, qytetar i Republikës së Bullgarisë, lindur në Sofie, në 07.11.1972, me pashaportë No 340390019;
4. z. Vasil Hristov Hristov, qytetar i Republikës së Bullgarisë, lindur në Sofie, në 17.06.1975, me pashaportë No 341913492;
5. z. Martin Tsvetkov Bogdanov, qytetar i Republikës së Bullgarisë, lindur në Sofie, në 11.06.1974, me pashaportë No 340186593;

8.3 Banka do të ketë drejtorin, e cila është organi ekzekutiv i Bankës dhe Anëtarët e saj caktohen dhe largohen nga detyra me vendim të Këshillit Drejtues. Anëtarët e Drejtorisë do të zgjidhen në drejtorin vetëm kur ata do të i përgjigjen të legjislacionin bankar.

8.4 Banka mbikqyret nga një Komitet Kontrolli, anëtarët e të cilit zgjidhen nga asambleja e aksionerëve. Komiteti i Kontrollit, gjatë kryerjes së funksioneve të tij, nuk do të jetë nën varësinë ose ndikimin e drejtimit ekzekutiv (Drejtorisë) të Bankës. Anëtarët e



Komiteti te kontrollit zgjidhen per nje afat kohor prej dy vitesh me te drejte rizgjedhje. Numri i anetareve te Komitetit te kontrollit eshte jo me i vogel se tre.

Komiteti i pare i kontrollit do te kete perberje si me poshte:

1. Matthew Aleksandrov Mateev, qytetar i Republikes se Bullgarise, lindur ne Sofie, ne 02.07.1959, me pashaporte No 304068249;
2. z. Evgeni Lukanov, qytetar i Republikes se Bullgarise, lindur ne Sofie, ne 07.11.1972, me pashaporte No 340390019;
3. z. Radoslav Milenkov, qytetar i Republikes se Bullgarise, lindur ne Sofie, ne 12.04.1972, me pashaporte No 322180631;

8.5 Anetare te Drejtorise dhe punonjes te tjere nuk mund te jene anetare te Komitetit te kontrollit. Anataret e Komitetit te kontrollit duhet t'u pergjigjen kriterëve, te cilave ju pergjigjen anetaret e komiteve te kontrollit ne perputhje me legjislacionin bankar.

Neni 9

Viti financiar, valuta

9.1 Viti financiar fillon me datë 1 janar dhe përfundon me 31 dhjetor të çdo viti kalendarik, me përjashtim të vitit të parë që fillon në datën e regjistrimit të Bankës pranë organeve tatimore.

9.2 Banka do të përgatisë pasqyrat financiare vjetore në Lekë Shqiptare. Për më tepër, pasqyrat financiare do të konvertohen në euro (ose në leva bullgare nëse kërkohet) dhe do të kryejë raportimin përkatës.

Ky akt themelimi eshte hartuar ne pese ekzemplare ne gjuhen bullgare dhe ne gjuhen shqipe dhe cdo njeri prej tyre ka te njejten vlere ligjore.

Stanimir Ivanov Mutafchiev /firme/

Todor Ludmilov Breshkov /firme/

Borislav Kirilov Niklev /firme/

Me 01.08.2005, Noteri Dimo Zheljazkov

Noter me veprim ne rajonin e Gjykates rajonale te Sofies

Regjj. No 101 ne Dhomen e Notereve,

Vertetoj firmat mbi kete dokument, i nenshkruar nga:



Stanimir Ivanov Mutafchiev FIB, Todor Ludmilov Breshkov FFBH

Borislav Kirilov Niklev FIBC

Me vendbanim: Sofia

Regjistruar No: 4024 takse e mbledhur leva

Noter: /firme, vule/

APOSTILLE

(Convention de La Haye du 5 octobre 1961)

1. Shteti: Republika e Bullgarise

2. Ky akt publik eshte nenshkruar nga

Dimo Zheljazkov

3. Ne cilesine e tij si

Noter No 101 - Sofia

4.dhe i eshte vendosur vula/pulla

Noter No 101

I legalizuar ne

5. Sofie, Bullgari. 6. me 02.08.2005

7. Nga Ministria e drejtesise

8. me numer 69477 /502-2.50

9. Vule. 10. firme

Une Ilda Avni Xhelili, vertetoj sakesine e perkthimit te kryer prej meje, per dokumentin e aplikuar

